Datë 21.07.2025 Prot.40 (dyzetë)

Protokoll nr. 40

I mbajtur sot më datë 21.07.2025, në mbledhjen jashtë radhe të Këshillit Bashkiak Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00.

Rend Dite:

1.Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2.Deklarimi i konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimmarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 23.04.2025.
4.P-V "Për miratimin e Ndihmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin maj 2025";
5.P-V "Për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 në nivel programi";

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari; Ronaldo Skënderi; Marinathi Avrami; Xhuana Hoxhallari; Enida Avdolli; Ilia Xhuti; Klea Baçi; Pranvera Begolli; Eriseld Jonusllari; Dritan Çami; Gentiana Drabo; Rovena Terolli; Fevri Sherifi; Floreta Zaçe; Kristina Malelli; Aramando Dautllari; Dalina Krekas; 17(shtatëmbëdhjetë) këshilltarë

Mungesa: Danjela Ibrahim; Petrit Kupe; Idlir Limllari; Plator Çollaku; Server Xhuti; Lulëzim Hoxhaj; Almir Elezi; Andonaq Risto; Neresida Shindo; Marjeta Xhelollari; Eglantina Balli;Yllson Ibrahimllari; Faslli Zholi; Albina Xhejo 14 (katërmbëdhjetë) këshilltarë.

Të pranishëm nga Administrata: Drejtore e Drejorisë të Financës dhe Buxhetit; znj.Almira Muka; Drejore e Shërbimit Social:znj.Ermanda Petriti;

Ornildi Demollari: Mirëdita të gjithëve! Të nderuar kolegë Këshilltarë, i nderuar Kryetari i bashkisë, të nderuar pjesmarës, fillojmë këtë mbledhje të radhës të Këshillit Bashkiak, ashtu sikur jeni njoftuar, verifikojmë korumin.Korumi realizohet pasi janë gjashtëmbëdhjetë-shtatëmbëdhjetë këshilltarë prezent në sallë, kështu që mund të vijojmë me mbledhjen.

Ornildi Demollari: Ju ftoj të miratojmë rendin e ditës, i cili përbëhet nga pesë pika.

-Hapja e mbledhjes, korumi, deklarimi i konfliktit të interesit janë këto pika që janë të përhershme pothuajse.

-Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 30 maj 2025 kemi për të miratuar një procesverbal mbledhje.

- Pika katër është projektvendim për miratimin e ndihmës ekonomike deri në masën gjashtë për qind të fondit për muajin qershor dy mijë e njëzet e pesë. Gjykuam që, meqënëse zhvillojmë këtë mbledhje jashtë radhë, të shtojmë në rendin e ditës edhe ndihmën ekonomike. Me qëllim që të mos ngelet pa kaluar, sepse deri më tani, deri më sot që po flasim, nuk ka materiale për mbledhjen, për një mbledhje të radhës të Këshillit të Bashkisë, nëse s'do ketë materiale në ditë në vijim, s'do bëj mbledhje.Për këtë përfundmuaj, ndoshta shtyhet edhe pak dhe menduam që ndihmën ekonomike ta kalojmë në këtë mbledhje jashtë radhë.

- Dhe pika e pestë, pika e fundit, është projektvendim për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm dy mijë e njëzet e pesë. Në nivel programi, ky është rendi i ditës për sot.

Ornildi Demollari: E miratojmë rendin e ditës?

Kush është dakord ? 16 vota pro
Kundër? Nuk ka.
Nuk ka abstenim, nuk ka.
Miratohet . Me 16 vota pro. Faleminderit..

Ornildi Demollari: Më lejoni të ju kujtoj deklarimin e konfliktit të interesit. Nëse ndonjë nga kolegët që është prezent në sallë ka konflikt interesi me ndonjërën nga pikat e rendit të ditës, është mirë që të mos përfshihet as në diskutim, as në votim.

Ornildi Demollari:Ju ftoj tani të miratojmë protokollin e mbledhjes së datës tridhjetë i pesti dy mijë e njëzet e pesë.

Kush është dakord me protokollin ? 17 vota pro
Kundër? Nuk ka.
Nuk ka abstenim, nuk ka.
Miratohet . Me 17 vota pro. Faleminderit.Kalojmë tek pika e katërt e rendit të ditës, projektvendim për miratimin e ndihmës ekonomike deri në masën gjashtë për qind të fondit për muajin qershor dy mijë e njëzet e pesë.Ka ndonjë pyetje për këtë, ndonjë koment?Drejtoreshë Alma?Ke gjë këtu?Jo, e kalojmë votim.

Atëherë, kush është dakord? 16 vota pro.

Kundër? Nuk ka

Nuk ka abstenim, nuk ka

Mmiratohet.materiali për ndihmën ekonomike, me 17 vota pro.

Ornildi Demollari:Shkojmë tek pika pesë e rendit të ditës.Projekt-vendim për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm.Për harkun kohor dy mijë e njëzet e gjashtë, dy mijë e njëzet e tetë, kush e do fjalën?

Pranvera Begolli: Aktualisht, ne të komisionit të financës, një pjesë e grupit u mblodhëm. Besoj se është një procedurë që bëhet çdo vit është një procedurë që duhet të miratohet, meqënëse shefen e financës e kemi këtu.Ajo mund të bëjë sqarimet e duhura që këshilltarët e tjerë po të kenë pyetur t'i bëjnë ne si komision financë.Jemi dakord ta kaloni.

Ornildi Demollari: Dua të di, e kemi zhvilluar disa seanca dëgjimore me qytetarët për këtë çështje?Ju si komision financë nuk e di a i keni përcjellë tek drejtoria e financës sugjerimet që morëm ne nga qytetarët.

Pranvera Begolli: Natyrisht, komisioni i financës do bëjë një procesverbal për t'i përcjellë ato, por meqënëse atë ditë prezent ishte vetë shefja e financës, ajo i ka marrë të gjitha problematikat që dolën atë ditë në takimin që bëmë ne në dëgjesën publike me qytetarët dhe me kryetarët e fshatrave dhe besoj se ato do përfshihen në këtë buxhet.Ju falemnderit.

Ornildi Demollari: Mirë faleminderit.Drejtoresh, po ke fjala.

Drejtore e Drejorisë të Financës dhe Buxhetit; znj.Almira Muka:Përshëndetje! Tani, sipas rendit të ditës që kemi për miratimin e këtij projekt vendimi për miratimin e tavaneve përfundimtare të shpenzimeve të PBA-së. E veçanta e këtij project-vendimi këtë radhë është sepse u janë marrë parasysh edhe dëgjesat që u bënë me këshillin, krahas dëgjesave që i bëmë në muajin prill, bashkë me këtë.Ne si bashkim me komunitetin dhe me grupet e interesit, këtu kemi marrë parasysh edhe dëgjesa që u bënë me këshillin.Në relacion janë të shpjeguara të gjitha ato që u morën parasysh, por të specifikuara ose analitike do të dalin në. Krahas të gjithave që do bëhen në shtator dhe në tetor, që ka po këshilli.Dhe pastaj, kur bëhet project-vendimi për miratimin e tavaneve përfundimtare, që bëhet në dhjetor, do të jenë më analitike ku janë prekur.Në relacion jemi munduar që t'i prekim të gjitha ato që u thanë atë ditë, krahas atyre të komunitetit që kemi marrë vetë si bashki, edhe me ato mendimet e këshillit.Po t'i shikoni në tavane përfundimtare, ose ato që dolën atë ditë janë më shumë për ujitjen për kanale të ftohtë. Dhe është një fond i konsiderueshëm në ujit të kullimit, që është lënë për shpenzime, që është shtuar domethënë në këto tavanet përfundimtare. Gjithashtu, edhe ujësjellësi i Moglicës dhe këto janë futur që në këtë vit. Domethënë, po bëhet ujësjellësi i Moglicës edhe në Gopeshë e nëpër ato të tjerat.Një problem që ngeli, që kjo nuk e di, mund t'ju jepte sqarim për digën e zëmblakut që u

ngrit.Po kjo do jetë të thashë në vazhdim, se është investim i madh dhe nuk mund ta bëjë bashkia.Do jetë në bashkëpunim me drejtorinë e ujitje kullimit në qendër, gjithashtu erdhi dhe udhëzimi i Ministrisë së Financave. Nuk pati ndryshime në transfertat e pakushtëzuara dhe të kushtëzuara që vjen. Ato futen në sistem, domethënë të gjitha janë të kuadruara sipas zërave.

Ornildi Demollari:Mirë,faleminderit. Le të shpresojmë që edhe në fazat e mëvonshme.Përgatitja e PBA-së të shkojë në mënyrë të suksesshme.

Atëherë kemi ndonjë pyetje? E kalojmë votim?
Kush është dakord ? 17 vota pro
Kundra. Nuk ka
Abstenim. Nuk ka.
Mmiratohet me 17 vota pro.Faleminderit!

Ornildi Demollari: Dhe këto ishin pikat e rendit të ditës për sot.Ju falenderoj, nuk e di nëse kemi ndonjë gjë.Tek të ndryshme se kemi, por mund të rezervojmë një hapësirë kohore në qoftë se kemi ndonjë shqetësim, ta ndajmë.Do ishte mirë të ishte kryetari, por është drejtoresha. Kemi ndonjë gjë?

Ornildi Demollari:Atëherë ju kujtoj, nesër kemi një dëgjesë publike që organizon këshilli.Do t'ju lutesha të jeni prezent, kush mundetPër menaxhimin e mbetjeve, orarin e kemi në ora njëmbëdhjetë këtu tek salla e këshillit.Shumë faleminderit, ditë të mbarë në vazhdim.Kjo ishte mbledhja.

Mbajtës Protokolli

SEKRETARI I KËSHILLIT

Gertjan GJIRITI

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI